



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA PATOS**  
**DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**  
**SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE DHE STREHIMIT**

Nr. 493 Prot.

Patos, më 19/02 /2024



**MIRATOHET**  
**KRYETARI**  
**Fation Duro**

**PROJEKTVENDIM**

Nr. 13, datë 19/02 /2024

**PËR MIRATIMIN E BONUSIT TË QIRASË SË**  
**QYTETARIT Z. QEREM ZYBERI**

**KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS**

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social” pika 2, gërma “a” dhe VKM-së nr. 459, datë 03.07.2019 “Për rregullat për administrimin e kërkesave të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionin e qirasë ose uzufruktit, mënyra e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehim, si dhe VKB-së nr. 81 datë 18.12.2023 për miratimin e buxhetit i kërkojmë Këshillit të Bashkisë:

1. Të miratoj bonusin e qirasë për periudhën 1-vjeçare janar-dhjetor 2024 për qytetarin në vlerën 36,000 (tridhjetë e gjashtë mijë) lekë.
2. Ky rimbursim të bëhet me 2 (dy) këste pasi qytetarit mund t'i ndryshoj statusi social, dhe me vërtetimin pas 6-muajsh të rimbursohet pjesa e mbetur.

**Anëtarët e Programit të strehimit social**

**1. Boreta Murati**

**2. Anisa Kripa**

**3. Fabjola Dervishaj**

**4. Grisilda Bektashi**

**5. Edona Beqaj**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA PATOS**  
**DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**  
**SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE DHE STREHIMIT**

Nr. 493 / Prot.

Patos, më 19/12 /2024

**RELACION**  
**MBI PROJEKTVENDIMIN**  
**PËR MIRATIMIN E BONUSIT TË QIRASË SË**  
**QYTETARIT Z. QEREM ZYBERI**

Të nderuar Këshilltar !

Në vijimësi të kërkesës të z.Qerem Zyberi për të përfitur bonusin e qirasë si familje në nevojë theksojmë se:

Qerem Zyberi banues në lagjen “Naftëtari” Patos, ka aplikuar si i pastrehë dhe figuron në listën e strehimit me numër rendor 104 (njëqind e katër). Familja e tij përbëhet nga katër persona. dhe në përbërjen familjare ka bashkëshorten me aftësi të kufizuar.

Të ardhurat e familjes janë në total 25,446 (njëzet e pesëmijë e katërqind e dyzet e gjashtë) lekë sipas K.M.P.V. Sipas kontratës së qirasë me nr. repertori 3388, nr. koleksioni 1621 datë 04.10.2023 familja e Qerem Zyberi jeton në këtë banesë, me numër pasurie 21/11+3-25, zona kadastrale 2890, volumi 13, faqe 54, me sipërfaqe 48.92 m<sup>2</sup> (dyzet e tetë pikë nëntëdhjetë e dy) në lagjen “Naftëtari” me një afat kohor kontrate 1 (një) vjeçar.

Në V.K.B nr. 81, datë 18.12.2023 për miratimin e buxhetit 2024, zëri rimbursimi i familjeve të pastreha për bonus qiraje. Për familjet që si pjesë taksuese sipas normave të strehimit duhet të strehohen në banesën 2+1, vlera në tregun e lirë e tetstuar është 6,000 (gjashtë mijë) lekë dhe rimbursim 50% e vlerës është e barazvlefshme me 3,000 (tre mijë) lekë në muaj. Për periudhën një vjeçare janar-dhjetor 2024 një vlerë totale 36,000 (tridhjetë e gjashtë mijë) lekë. Kjo vlerë të rimbursohet me dy këste, pasi qytetari mund t’i ndryshoj statusi social.

Për sa më sipër, i kërkojmë Këshillit të Bashkisë:

1. Miratimin e këtij projektvendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet drejtoria e financës.

**Anëtarët e Programit të Strehimit Social**

1. Boreta Murati

2. Anisa Kripa

3. Fabjola Dervishaj

4. Grisilda Bektashi

5. Edona Beqaj

6. Shkëlqim Beqiraj



**KRYETARI**  
**Faton Duro**